



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada - Government  
Komuna e Drenasit  
Zyra e Kryetarit



01- Nr 020/04-29677 dt. 21. 06. 2023

Në vështrim të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores Nr. 12 nr.320-19338 dhe plotësimin së rregullores me nr 02-400/01-18380 të dt. 07.04.2022 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, rregullores MF-NR 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nenit 49 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe sipas propozimeve të dhëna në procesverbalin me nr. 01 nr. 060/04-34364, Kryetari i Komunës, mori këtë:

## **V E N D I M**

**Për formimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike, nga Drejtoria për kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2023**

I .Anëtarët e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike, nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2023, janë:

1. Fatlinda Zymberi
2. Hazir Elshani
3. Albert Rama
4. Mehdi Ademi
5. Lumturiye Kiçina
6. Mimoza Berisha-Anëtarë rezervë

II. Komisioni ka për detyrë të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për kërkesat për subvencionim përmes thirrjes publike për aplikim për vitin 2023, duke u bazuar në Rregulloren 12.Nr. 320-19338 plotësimin së rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve si dhe në rregulloren procedurat e ndarjes së

subvencioneve si dhe në Rregulloren MF- NR 04/2017 Mbi kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve

III. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike për aplikim nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2023, punën e tyre duhet ta kryejnë me profesionalizëm të lartë dhe përkushtim.

IV. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike për aplikim nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2023, ka për obligim që të shqyrtoj dhe vlerësoj të gjitha kërkesat pranë kësaj drejtorie në afatin kohor të përcaktuar me rregulloren 12 nr.320-19338 dhe plotësimin së rregullores me nr 02-400/01 18380 të dt. 07.04.2022 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve dhe rregullores MF-NR 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe në të njëjtën kohë të njoftoj me shkrim Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimin e kërkesave.

V.Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Personelit;
- Anëtarëve të Komisionit;
- Arkivit të Komunës



**KRYETARI I KOMUNËS**

*[Signature]*  
Ramiz Lladrovci